

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Data: Datum: Date:
01B	1844
3	04, 06, 20 11
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Prishtinë, 4 qershor 2015
Ref. 211/01B

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, duke u bazuar në nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), nenin 8 (1.4) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), vendimit nr. 262/01B të datës 29.08.2011, vendimit nr. 292/01B të datës 22.10.2012 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 23/2014, nxjerr:

V E N D I M

për procedurat e vlerësimit përfundimtar dhe të vlerësimit përmbyllës në shkollat pilot

1. Procedurat e zbatimit të vlerësimit përfundimtar:

- 1.1. Vlerësimi përfundimtar realizohet në fund të kryerjes së çdo klase dhe bëhet për çdo lëndë mësimore.
- 1.2. Nota përfundimtare e secilës lëndë mësimore për klasë nxirret nga mesatarja aritmetike e notave numerike të dy gjysmëvjetorëve të vitit shkollor.
- 1.3. Nota përfundimtare e fushës nxirret nga mesatarja aritmetike e notave përfundimtare të lëndëve mësimore të fushës përkatëse.
- 1.4. Nota përfundimtare e fushës kurrikulare nxirret vetëm për nxënësit/et që kanë të gjitha notat kaluese në lëndët e fushës kurrikulare.
- 1.5. Notën përfundimtare për fushë të kurrikulës e vendos kujdestari/ja i/e klasës në konsultim me mësimdhënësit/et e lëndëve të fushës së kurrikulës, duke respektuar në mënyrë të përpiktë mesataren aritmetike të notave përfundimtare të lëndëve mësimore të fushës së kurrikulës përkatëse.
- 1.6. Nota përfundimtare për fushë të kurrikulës vendoset në ditë (libër të klasës) vetëm pasi nxënësi të ketë arritur minimumin e domosdoshëm të

rezultateve të të nxënit për çdo lëndë të fushës së kurrikulës, që nënkupton notën dy (2) për lëndë mësimore.

- 1.7. Në rast se nxënësi/sja nuk e ka arritur minimumin e domosdoshëm të rezultateve të të nxënit (notën dy (2) për lëndë mësimore) në jo më shumë se tri lëndë mësimore, atëherë i mundësohet mësimi plotësues. Mësimi plotësues organizohet nga shkolla me kohëzgjatje jo më pak se dy javë mësimore dhe jo më pak se dy orë mësimore në ditë për lëndë mësimore përkatëse. Mësimi plotësues organizohet nga mësimdhënësi i lëndës mësimore përkatëse.
- 1.8. Në rast se nxënësi/sja edhe pas mësimit plotësues nuk e arrin minimumin e domosdoshëm të rezultateve të të nxënit, atëherë i jepet e drejta për t'iu nënshtruar vlerësimit përfundimtar për lëndë para përfundimit të vitit shkollor, brenda periudhës 15-31 gusht të vitit 2015. Nëse edhe në këtë vlerësim nxënësi/sja nuk e arrin minimumin e domosdoshëm të rezultateve të nxënit në lëndët përkatëse, atëherë e përserit klasën në klasat pilot: 6, 7, 10 dhe 11. Ndërsa në nivelin e parë të arsimit (klasat 1 dhe 2) nxënësi/ja nuk e përserit klasën, por përcillet në klasën vijuese. Në raste të veçanta, në marrëveshje me prindin, nxënësi/ja i këtij niveli mund të përsërisë klasën. Në raste të tilla mësimdhënësi/sja së bashku me prindin bëjnë një plan të përkrahjes së nxënësit/es për arritjen e rezultateve të të nxënit dhe e zbatojnë atë gjatë gjithë vitit mësimor në vijim.
- 1.9. Nota përfundimtare e fushës vendoset në ditar, në libër amë dhe në dëftesë të klasave përkatëse. Nota vendoset me shkronjë dhe me mesatare të arritjes (p.sh. A / 4.60).


2. Procedurat e zbatimit të vlerësimit përmbyllës:

- 2.1. Vlerësimi përmbyllës në vitin shkollor 2014/2015 realizohet në mbarim të shkallës, në klasat 2, 7 dhe 11.
- 2.2. Vlerësimi përmbyllës bëhet në bazë të listës së rezultateve të të nxënit (kompetencave) për shkallë të kurrikulës.
- 2.3. Vlerësimi përmbyllës për vitin shkollor 2014/2015 nuk vendoset në dëftesat e klasave përkatëse.
- 2.4. Dokumentimi i vlerësimit përmbyllës për këtë vit shkollor (2014/2015) vendoset në procesverbalet/ fletat e veçanta, në librat e klasave përkatëse dhe në procesverbalet/ fletoret e aktiveve profesionale.
- 2.5. Vlerësimi përmbyllës për vitin shkollor 2014/2015 organizohet nga shkolla, respektivisht mësimdhënësit/et e përfshirë në klasat pilot përmes analizës së dëshmimeve të mbledhura për secilin nxënësi/e për arritjen e rezultateve të kompetencave për shkallën përkatëse të kurrikulës.
- 2.6. Vlerësimi përmbyllës për vitin shkollor 2014/2015 bëhet me qëllim të konstatimit të nivelit të arritjes së rezultateve (kompetencave) për shkallë dhe të planifikimit të përkrahjes së nxënësve/eve nga shkolla në vitin shkollor në vijim.

3. Vendimi vlen për vitin shkollor 2014/2015 dhe ju përgjigjet nevojave dhe kërkesave të procesit të pilotimit të kurrikulës.
4. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Arsim BAJRAMI
Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Vendimi ju dërgohet:

- Drejtorive Komunale për Arsim;
- Shkollave Pilot;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
- Departamentit për Politika të Arsimit Parauniversitar, MASHT;
- Departamentit për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar, MASHT;
- Departamentit të Inspeksionit të Arsimit, MASHT;
- Arkivit të MASHT;